

Znj. Elira Cukalla ka përfunduar studimet e larta në vitin 2004 në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës - dega Informatikë.

Ajo ka një eksperiencë 20 vjecare në profile të ndryshme të Teknologjisë së Informacionit, ku 10 vite i përkasin sektorit privat, me një eksperiencë të plotë në administrimin e sistemeve informatike.

Prej më shumë se 10 vitesh, bën pjesë në strukturën e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ku ka zhvilluar një rritje profesionale të përshkallëzuar dhe për më shumë se 6 vjet.ka mbajtur pozicionin e Auditueses së Lartë në Departamentin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

Aktualisht, Znj. Cukalla mban detyrën e “*Kryeaudituesit*” në Departamentin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

Për rritjen e saj profesionale, ka ndjekur disa trajnime të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e IT, të cilat janë shoqëruar dhe me certifikimet përkatëse në:

- OCA - Oracle Certified Associate;
- ISO 20000-1: 2018 Lead Auditor;
- ISO 27001: 2013 Lead Auditor;
- Online Training Programme on “Auditing in IT Environment”.

Gjithashtu, znj. Cukalla ka marrë pjesë aktivisht në projektet e bashkëpunimit për rritjen e kapaciteteve profesionale audituese që KLSH ka zhvilluar me Institucionet Supreme të Auditimit të Polonisë, Norvegjisë, etj. Pjesëmarrje aktive ka zhvilluar edhe në trajnime, konferenca dhe seminare të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, në tema që lidhen me auditimin e teknologjisë së informacionit.

Znj. Cukalla është njohëse e mirë e gjuhës angleze dhe italiane.